

The original English version is the authoritative version on which this unofficial translation is based.

[Towards a Recommendation on Open Culture — 2 Pajer](#)

DRPKH: Drejt një rekomandimi për kulturë të hapur

Çka është DRPKH?

Drejt rekomandimit për kulturë të hapur apo DRPKH ose TAROC është një iniciativë e komunitetit e nisur nga Creative Commons që ka për qëllim mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar në zhvillimin e një instrumenti ndërkombëtar normativ, që është pozitiv, afirmativ dhe ndikues (një "rekomandim") që cakton vlerat, qëllimet dhe mekanizmat që kultura e hapur të zhvillohet tutje. Një instrument i tillë vlerëson rëndësinë e shpërndarjes globale të kulturës së hapur si formë e aktivizimit dhe mbështetjes së ambicieve politikbërëse kulturore dhe informative. Tash, nuk ka një terminologji formale për "kulturën e hapur" por kuptohet si përfshirje e gjerë dhe qasje gjithpërfshirëse në trashëgimi kulturore dhe kreativitet bashkëkohor.

Pse DRPKH?

Organizata e Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë (UNESCO) promovon bashkëpunimin ndërkombëtarë në fushën e edukimit, shkencës, kulturës poashtu komunikimit dhe informacionit. Në vitet e kaluara, UNESCO ka adaptuar Rekomandimet për Burime të hapura edukative dhe shkencë të hapur, por tani ende nuk ka ndonjë instrument që nxit kulturën e hapur.

Shpërndarja më e mirë - shpërndarje që është e lirë, etike, e drejtë, gjithpërfshirëse, e qëndrueshme, reciproke dhe e përgjegjshme - është çelësi që mundëson të gjithë të shijojnë kulturën. Në 2022, Deklarata e UNESCO Mexico City MONDIACULT afirmoi se kultura është një e mirë publike. Megjithatë, korniza e politikbërjes aktuale nuk është e pështatshme për të realizuar këtë ambicie:

- Qytetarët në të gjithë botën duhet të kenë të drejtën e qasjes kuptimplotë në trashëgiminë kulturore globale të mbajtur në institucionet e trashëgimisë kulturore, në

mënyrë që të kuptojnë të tashmen e tyre dhe të krijojnë të ardhmen e tyre. Gjithsesi, ata aktualisht përballen me sfida të shumta për të përjetuar, interpretuar dhe për tu lidhur me trashëgiminë e tyre dhe me njëri-tjetrin.

- Institucionet e trashëgimisë kulturore, duke përfshirë galeritë, bibliotekat, arkivat dhe muzetë (GBAM) – që në shumicë financohen nga publiku – janë hapësira kryesore ku qytetarët mund të marrin pjesë në kulturë dhe të kontribuojnë në ndërtimin e shoqërive të bazuara në dije dhe lehtë të adaptueshme. Megjithatë, shumë GBAM nuk mund të përmbushin misionet e tyre në botën dixhitale, duke përfshirë ndarjen e koleksioneve si pjesë e përpjekjeve për t'i mbrojtur, ruajtur ose vënë në dispozicion të publikut për edukim, kërkim ose admirim.

Kultura e hapur është një mjet për të kapërcyer këto sfida. Ekziston një nevojë urgjente të ketë kulturë të hapur për të gjithë. Kultura e hapur nuk mund të ketë progres pa:

- Një mjedis politikash globale – duke përfshirë ligjet, standardet, normat, kornizat dhe praktikant – që mbështesin kulturën e hapur në masën më të plotë të mundshme.
- Njerëz të fuqizuar që promovojnë dhe praktikojnë në masë të madhe kulturën e hapur.
- Infrastruktura të hapura dixhitale publike, jofitimprurëse dhe/ose të qeverisura kolektivisht për të mbështetur shpërndarjen dhe ndërveprimin e njerzve me kulturë, duke përfshirë softuerët me burim të hapur, si dhe infrastrukturën e hapura teknike, ligjore dhe shoqërore.
- Financim i qëndrueshëm dhe i mjaftueshëm për GBAM-të, krijuesit dhe për infrastrukturën e hapura.

Cilat janë qëllimet e DRPKH?

DRPKH ka vizion një kornizë të politikave ndërkombëtare dhe programe të përbashkëta pune që njohin potencialin e kulturës së hapur si një mjet primar për të arritur qëllimet e agjendës më të gjerë të politikave kulturore, duke përfshirë edhe:

- Mbrojtjen e të drejtave themelore të secilit sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948):
 - Lirinë e shprehjes dhe qasjen në informacion - Neni 19
 - Pjesëmarrjen e lirishme në jetën kulturore të komunitetit dhe ndërveprimin me artet - Neni 27 (1) Arritje e Objektivave të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG) në lidhje me kulturën, veçanërisht trashëgiminë kulturore
- Mundësimi që të gjithë të përfitojnë nga kultura si një e mirë publike globale
- Nxitja e krijimtarisë bashkëkohore, e cila plotëson dhe shoqëron instrumentet ekzistuese të UNESCO-s, duke përfshirë ato që mbrojnë të drejtat e artistit:

- Mbështetjen e krijuesve dhe artistëve që dëshirojnë t'i bëjnë veprat e tyre të hapura për publikun
- Mundësimi që të gjithë të zbulojnë, të kenë qasje, të ndajnë, të përdorin, ripërdorin dhe miksojnë trashëgiminë kulturore në domenin publik dhe të hapin materiale kulturore bashkëkohore sipas dëshirave dhe zgjedhjeve të lira artistike.
- Të nxitet ruajtja, mbrojtja, mirëmbajta, përhapja dhe rigjallërimi i trashëgimisë kulturore
- Të rritet qasja në trashëgiminë kulturore për personat me aftësi të kufizuara
- Të fuqizohen grupet e marginalizuara duke përfshirë të rinjtë, gratë dhe popujt autoktonë në përputhje me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Popujve Autoktonë (2007)
- Të mbështeten modelet e reja për shpërblimin e drejtë dhe qëndrueshmërinë financiare të krijuesve
- Të rritet mbrojtja dhe promovimi i diversitetit të trashëgimisë kulturore dhe shprehjeve kulturore
- Të ndërtohen shoqëri të bazuara në njohuri dhe mbështetje e mësim për aftësi teknologjike dixhitale të reja dhe mbështetje e sektorit kulturor përmes tranzicioneve teknologjike
- Të luftohet trafikimi i paligjshëm i trashëgimisë kulturore
- Të lehtësohet kthimi dhe rivitalizimi i trashëgimisë kulturore
- Të sigurohet një e ardhme e qëndrueshme për GBAM dhe koleksionet e tyre
- Të promovohet dialogu, mirëkuptimi ndërkulturor dhe ndarja e informacionit të besueshëm
- Të rritet niveli i kërkimit, edukimit dhe mësimin lidhur me trashëgiminë kulturore dhe artet për të përballuar sfidat më të mëdha të botës
- Të gjallërohet arti, kultura dhe krijimtaria për të na ndihmuar të jetojmë jetë më të pasur
- Të promovohet diversiteti, gjithëpërfshirja dhe barazia për të mbështetur shoqëri të drejta, demokratike dhe të adaptueshme
- Të nxiten institucionet e trashëgimisë kulturore në botën dixhitale me investime publike për të siguruar rëndësinë e tyre të vazhdueshme, përafrimin e misionit dhe orientimin e shërbimeve

Kush po drejton DRPKH?

Ne jemi një komunitet i përbërë nga vullnetarë, bibliotekarë, ekspertë të së drejtës së autorit, antropologë, artistë, arkivistë, krijues, akademikë, kuratorë, studiues, avokat, aktivistë, institucione të trashëgimisë kulturore/praktikues të GBAM, dhe të tjerë

të përfshirë në trashëgiminë kulturore dhe krijimtarinë bashkëkohore. Ne besojmë në fuqinë transformuese të kulturës së hapur.

Çfarë bën Creative Commons?

CC u themelua në vitin 2001 dhe për më shumë se dy dekada ruan qasjen në kulturë. Që nga fillimi i DRPKH në 2023, ne:

KRIJO: Ne bashkë-krijojmë burime për të rritur ndërgjegjësimin, për të ndarë njohuritë dhe për të nxitur ide të reja rreth ndërtimit të paradigmave të reja kulturore, të tilla si:

- Kultura e hapur - Prapavija dhe Konteksti
- Kultura e Hapur - Një përshkrim Punues
- Kultura e Hapur - Vlerat dhe Parimet
- Kultura e Hapur - Objektivat dhe Rezultatet

SHKËMBIM: Ne nxisim hapësirat për të zhvilluar biseda globale dhe lokale për të shkëmbyer përvoja nga jeta reale

BASHKËPUNIM: Ne ndërtojmë rrjete për të fuqizuar vullnetarët dhe entuziastët e kulturës së hapur dhe për të stimuluar bashkëpunimin midis individëve, komuniteteve, institucioneve, organizatave, sektorit privat dhe qeverive me të njëjtin mendim.

A jeni gati të bashkoheni?

Kontakto ekipin e Open Culture të Creative Commons në info@creativecommons.org

Creative Commons, 2023, CC nga International 4.0